



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport



13 Nr. Zyrtar – 2022
Me datë: 20.04.2022

Nr. i prot. 1377 Më Dt. 21-04 2022
Bz. prot. RAHOVEC - ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 24 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës Nr. 03/L-040 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008"), dispozitave të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, e në mbështetje të nenit 16 paragrafi 3 dhe 4 të Rregullores – MF – Nr. 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, nenit 63 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017 dhe Thirrjes Publike me Nr. Prot. 706 të datës 04.03.2022, dhe në mbështetje të vendimit me Nr. Prot. 02/1808 të datës 29.03.2022 për caktimin e Komisionit për shqyrtimin dhe vlersimin e aplikacioneve për ndarjen e subvencioneve në kulturë dhe rini nga DKRS-ja për vitin 2022, Komisioni vlerësues nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Për ndarjen e shumes financiare sipas projekteve per OJQ-te qe kane permbushur kushtet dhe kriteret sipas thirrjes publike per aplikim.
2. Pjese përbërëse e këtij vendimi është lista e përfituesëve te subvencioneve ne sektorin e kulturës dhe rinise për vitin 2022.
3. Pas kalimit të afatit të ankesave dhe të procedurave të tjera të parapara në rregulloret e lartcekura, Kryetari i Komunës do të nënshkruajë kontratat me përfituesit e mjeteve financiare me të gjitha OJQ-të përfituese.

LISTA E PËRFITUESËVE PËR SUBVENCIONE NË SEKTORIN E KULTURËS DHE RINISË 2022

Nr.	EMRI I OJQ / KLUBIT SPORTIV	EMRI I PROJEKTIT	ADRESA
1.	OJQ "ART STUDIO"	KOLONIA ARTISTIKE NDËRKOMBËTARE EDICIONI 21	RAHOVEC
2.	OVL – UÇK	ORGANIZIMI I MANIFESTIMEVE PËR DËSHMORËT E KOMBIT	RAHOVEC
3.	SH.K.A "BAJRAM CURRI"	KULTIVIMI I VLERAVE KULTURORE	K. E MADHE
4.	Q.K.A "JEHONA E ANADRINIT"	FESTIVALI FOLKLORIK "ANADRINIA JEHON 2022"	DEJNË
5.	OJQ "GRATË E VEJA"	TEMPULLI I LIRISË	K. E MADHE
6.	SH.K.A "RAHOVECI"	TALENTËT E RINJË NË MUZIKËN FOLKLORIKE	RAHOVEC
7.	SH.K.A. "GANIMETE TËRBESHI"	PLOTËSIM ME GARBEROBË DHE INSTRUMENTE	XËRXË
8.	SHL "KOSOVA"	TË RINJTË MË AKTIV NË RAHOVEC	RAHOVEC
9.	KËSHILLI RINOR RAHOVEC	N'KONAK T'RAHOVECIT NA BASHKON KËNGA SHOQPE	RAHOVEC
10.	ORGANIZATA KULTURORE E TË RINJËVE	TRASHEGIMIA KULTURORE E RAHOVECIT PËRMES FOTOGRAFISË	DEJNË

A r s y e t i m

Kryetari i Komunës me vendimin me Nr. Prot. 02/1808 të datës 29.03.2022 ka caktuar komisionin për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve për ndarjen e subvencioneve për OJQ-të në fushën e kulturës dhe rinisë për vitin 2022.

Pas kësaj, komisioni brenda afatit të përcaktuar ligjor ka bërë hapjen dhe vlerësimin e aplikacioneve të cilët kanë konkurruar për subvencione të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport për vitin 2022, duke u bazuar në kushtet dhe kriteret e përcaktuara në thirrjen për aplikim Nr. 706 të datës 04.03.2022.

Nga gjithsejtë 15 (pesëmbëdhjetë) aplikacionet e pranuar nga ana e komisionit, 10 (dhjetë) prej tyre i kanë plotësuar kriteret në bazë të thirrjes për aplikim ndërsa 5 (pesë) aplikacione janë refuzuar për shkak të dokumentacionit të pa kompletuar të paraparë me thirrjen publike për aplikim.

Andaj, nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Udhëzim Juridik: Pala e pakënaqur me këtë vendim ka të drejtë ankese në afat prej 5 (pesë) ditësh, nga dita e publikimit të tij pranë Komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e ankesave për ndarjen e subvencioneve për OJQ-të në fushën e kulturës dhe rinisë. Ankesa dorëzohet në sportelin Nr. 7 në katin e I-rë në objektin e Komunës.

Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve:

1. Shedad Ukaj – Kryesues _____
2. Muharem Morina – Anëtar _____
3. Admir Mullabazi – Anëtar _____
4. Bekim Kelmendi - Anëtar _____
5. Ardian Rama - Anëtar _____